



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kadastrit
Periudha raportuese	Mars, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Valbona Osmani – Mehmetaj, drejtore e Drejtorisë së Kadastrit

1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës ka vazhduar të bëjë ofrimin e shërbimeve sa më efikase për qytetarë, duke ofruar informacione dhe të dhëna të azhurnuara për pronat e paluajtshme.

Gjatë muajit mars 2020 në zyrat pritëse janë pranuar gjithsej **2039** kërkesa, nga të cilat janë aprovuar **1929** kërkesa, refuzuar **18** kërkesa dhe kanë mbetur në procedurë edhe **92** kërkesa, të cilat janë realizuar përmes **2 sektorëve**: Sektorit të kadastrit dhe Sektorit të gjeodezisë.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

Aktivitetet e planifikuara të Drejtorisë së Kadastrit:

- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim dhe çregjistrim të hipotekës;
- Shqyrtimi i kërkesave për përmirësim të regjistrave kadastralë;
- Shqyrtimi i kërkesave për regjistrim të banesave;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve;
- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë, parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njërive banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe ri-rregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave nga gjeodetët dhe kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.

Gjatë muajit **mars 2020**, përmes zyrave pritëse dhe 2 sektorëve, atij të kadastrit dhe të gjeodezisë, në Drejtorinë e Kadastrit janë pranuar kërkesa të ndryshme, prej të cilave:

Në sektorin e kadastrit janë përpunuar kërkesat në vijim:

- **200** kërkesa për regjistrim të pronësisë, prej të cilave janë aprovuar **138**, janë refuzuar **15** kërkesa për regjistrim të pronësisë, ndërsa janë njoftuar palët në procedurë me **47** konkluzione, duke u pezulluar procedura deri në plotësimin e lëndëve me dokumentacione përkatëse;
- **3** kërkesa për historik nga persona fizikë, institucione, prej të cilave është aprovuar **1**, ndërsa kanë mbetur në procedurë edhe **2**;
- **137** shkresa – kërkesa nga institucionet e ndryshme, ku janë aprovuar të gjitha;
- kërkesa për përmirësim me pagesë nuk ka pasur;
- **0** kërkesa për lirim të barrës tatimore dhe **0** kërkesa për vendosjen e barrës tatimore;
- **42** kërkesa për regjistrim të hipotekave dhe **44** kërkesa për çregjistrim hipoteke, ku janë aprovuar të gjitha;
- **84** përmirësime/ankesa/ plotësim lënde nga institucionet e ndryshme, prej të cilave janë aprovuar **68**, janë refuzuar **3**, ndërsa kanë mbetur në procedurë **13**.

Numri i përgjithshëm i kërkesave të pranura për këtë sektor ka qenë 510, nga të cilat 430 kërkesa janë aprovuar, 18 janë refuzuar dhe 62 kërkesa kanë ngelur në procedurë.

Në Sektorin e gjeodezisë janë përpunuar kërkesat në vijim:

- **1235** kërkesa për certifikata të pronësisë dhe kërkesa për kopje të planit, ku janë aprovuar të gjitha;
- **48** kërkesa për ndarje të parcelave, prej të cilave janë aprovuar **///** dhe **///** kanë mbetur në procedurë;
- **14** kërkesa për bashkim të parcelave, ku janë aprovuar të gjitha;
- **73** kërkesa për legalizim të objekteve, nga të cilat janë aprovuar **61**, në procedurë janë **13**;
- **7** kërkesa për përcaktimi të kufijve, ku janë aprovuar të gjitha;
- **12** kërkesa për rirregullim të kufirit të parcelës, ku janë aprovuar të gjitha;
- **21** kërkesa për identifikimin të parcelave-njësive banesore, prej të cilave janë aprovuar **18** dhe **3** kanë mbetur në procedurë;
- **86** kërkesa për dhënie të produkteve (koordinatave), ku janë realizuar të gjitha;
- **14** kërkesa për ndërrimin e destinimit të tokave-parcelave, ku janë aprovuar të gjitha;
- **6** plotësime të lëndëve, ku janë aprovuar të gjitha;
- **0** kërkesë për regjistrim të objekteve dhe njësive banesore;
- **13** kërkesa zyrtare për përmirësime nga palët dhe kërkesa zyrtare nga institucionet, si: Drejtoria e Pronës, Drejtoria e Urbanizimit, Ministria e Planifikimit Hapësinor, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) etj., ku janë aprovuar të gjitha.

Gjithsej numri i kërkesave të pranura për këtë sektor ka qenë 1529, prej të cilave janë aprovuar 1499 dhe 30 kanë mbetur në procedurë.

Nga të dhënat e lartshënuara shihet se Drejtoria e Kadastrit ka zbatuar gati **97** për qind (%) të planit të saj, duke i aprovuar, refuzuar ose pezulluar kërkesat e palëve në procedurë, sipas shqyrtimeve ligjore që ka bërë lidhur me këto kërkesa.

E arritur e kësaj drejtorie është se në afatin e përcaktuar ligjor prej 15 ditëve, ka arritur të nxjerrë vendime meritore për secilën prej kërkesave të parashtruara nga palët /subjektet juridike.

4. *AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.*

Nga Sektori i kadastrit në implementim e sipër janë këto aktivitete:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej **5** ditë pune, që kanë të bëjnë me regjistrimin e pronës së paluajtshme në operatin kadastral;
- Lëndët e dërguara në KPA, verifikim dhe pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët e dërguara për verifikim në gjykata, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal;

Nga Sektori i gjeodezisë në implementim e sipër janë këto aktivitete:

- Lëndët për ndarje, identifikim dhe bashkim të parcelave;
- Lëndët për identifikimin e njësive banesore;
- Lëndët për kërkesa zyrtare dhe kërkesa nga institucionet.

4.1.1. *STATISTIKAT- Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të këtë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.*

Kërkesat e pranuar në Drejtorinë e Kadastrit, mars 2020	Numri i përgjithshëm i kërkesave	Të aprovuara	Të refuzuara	Në procedurë	Mjetet e grumbulluara €
Kërkesa për RDPP (regjistrimi i të drejtës për pronë të paluajtshme)	200	138	15	47	6,776.00
Kërkesa për historik zyrtar, historik për persona fizikë dhe juridikë	3	1	0	2	20.00
Kërkesa nga Institucionet e ndryshme dhe përgjigjet nga Gjykata dhe institucione të	137	137	0	0	00.00

tjera - Shërbimi i RDPP-së					
Përmirësime në RDPP	0	0	0	0	0.00
Vendosje të barrës tatimore	0	0	0	0	00.00
Lirim nga barra tatimore	0	0	0	0	00.00
Kërkesat për regjistrim të hipotekave	42	42	0	0	5,760.00
Kërkesat për çregjistrim të hipotekave dhe ndryshime	44	44	0	0	540.00
Kërkesa të tjera: përmirësime, ankesa, plotësime lëndë etj.	84	68	3	13	130.00
Certifikata të pronësisë - Kopje të planit	1235	1235	0	0	5,543.00
Ndarje-parcelime - copëtimet	48	48	0	0	2,950.00
Bashkimi i parcelave	14	14	0	0	13,250.00
Legalizimi i objekteve	73	61	0	12	00.00
Dhënia e produkteve - pikave kadastrale (koordinatave)	86	86	0	0	1,535.00
Identifikimi i parcelave dhe njësive banesore	21	3	0	18	630.00
Përcaktimi i kufijve të parcelave	7	7	0	0	180.00
Rirregullimi i kufijve të parcelave	12	12	0	0	940.00
Ndërrimi i destinimit të tokës-parcelave	14	14	0	0	15,773.00
Plotësimi i lëndëve	6	6	0	0	00.00
Regjistrimi i objekteve dhe njësive banesore	0	0	0	0	00.00
Kërkesa zyrtare nga institucionet-Shërbimi i gjeodezisë (certifik. dhe kopje e planit)	13	13	0	0	00.00
Gjithsej	510	430	18	62	13,226.00

4.1.2 Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Drejtorja e Kadastrit nuk shpenzon buxhet për të regjistruar të drejtat pronësore në regjistrat kadastralë, përkundrazi, kjo drejtori realizon të hyra nga taksat e qytetarëve.

4.1.3 Takimet me palë

- **Spektori i kadastrit**, gjegjësisht Zyra për regjistrimin e pronës së paluajtshme (RDPP), ka takime të rregullta me palë dy herë në javë (të martave dhe të enjteve) nga 2 orë në ditë, me dy zyrtarë ligjorë, ku ofrohen këshilla për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të palëve. Brenda këtyre 2 ditëve, 2 zyrtarët e Zyrës për RDPP takohen me rreth **100** qytetarë.
- **Spektori i gjeodezisë** ka takime të rregullta me palë një herë në javë (të mërkurave) nga 2 orë, ku gjatë muajit mars ka pranuar **59** palë për plotësim të lëndëve sipas kërkesave të tyre për ndarje, bashkim ose rregullim kufiri. Po ashtu, ka takime me palë për identifikimin e banesave, si dhe takime të tjera me palë sipas kërkesave të tyre lidhur me çështjet pronësore.

5. Takimet me institucione të tjera

- **Spektori i kadastrit**, takim me qytetarët për çështje të ndryshme kadastrale pronësore, për të cilat kemi zgjidhje ligjore, ose i kemi udhëzuar palët që t'u drejtohen institucioneve të tjera në vend. Takim me Policinë e Kosovës, zyrtarë të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, zyrtarë të Agjencisë Kosovare të Privatizimit etj., lidhur me lëndët në procedurë dhe çështje të tjera.

5.1.1 Diskutime publike / Takimet me qytetarë - Nuk kemi pasur.

6. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

Spektori i kadastrit ka pasur vetëm një kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare, nga avokati Bekim Berisha, e cila është ende ne procedurë, pasi që zyrtarja e cila merret me këtë çështje gjendet në pushim, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për nënat vetushqyese.

6.1.1 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Spektori i kadastrit:

- Lëndë të pranuar: **510;**
- Lëndë të aprovuara: **430;**
- Lëndë të refuzuara: **18;**
- Lëndë në procedurë: **62.**

- Spektori i gjeodezisë:

- Lëndë të pranuar: **1529;**
- Lëndë të aprovuara: **1499;**
- Lëndë të refuzuara: **0**
- Lëndë në procedurë: **30.**

Takime të tjera - nuk ka pasur.

7. **SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Sfide e jashtëzakonshme gjatë këtij muaji për Sektorin e kadasrit dhe të gjeodezisë, ka qenë se kemi pasur numrin e stafit të zvogëluar, të cilët janë liruar nga Urdhëresa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për shkak të pandemisë COVID -19.

Spektori i kadastrit:

- Sfidues është komunikimi me institucionet, moskthimi i përgjigjeve të tyre në afat ligjor, të cilat na krijojnë probleme me palë dhe përfaqësues të palëve;
- 3 kërkesa presin për verifikime në Arkivin Komunal dhe Ndërkomunal;
- 18 kërkesa presin për verifikime në Gjykatë;
- 5 kërkesa presin për verifikime në Privatizim;
- 2 kërkesa presin për verifikime në NPB;
- 23 kërkesa presin për Verifikime në AKKVP.

Spektori i gjeodezisë:

- Mungesa e shënimeve në pjesën grafike.
8. **REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë etj.**

Spektori i kadastrit:

- Trajnime për punëtorë sa i përket administratës dhe funksionimit të saj.

Spektori i gjeodezisë:

- Trajnime për punëtorë për punën profesionale - gjeodezike dhe funksionimin e administratës.

9. **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES**
-Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:

Sektori i kadastrit:

- Lëndët në shpallje publike në afat prej 5 ditë pune;
- Lëndët në KPA për pëlqime për regjistrim të banesave;
- Lëndët për verifikim në gjykata, NPB, AKP, Arkiv Komunal ose Ndërkomunal.

Sektori i gjeodezisë:

- Shqyrtimi i kërkesave për ndarje të pronësisë;
- Shqyrtimi i kërkesave për dhënien e produkteve (koordinatave);
- Shqyrtimi i kërkesave për bashkim të parcelave;
- Shqyrtimi i kërkesave për identifikimin e njësisë banesore;
- Shqyrtimi i kërkesave për përcaktim dhe rirregullim kufiri;
- Shqyrtimi i kërkesave për gjeodetë apo kompanitë e licencuara;
- Shqyrtimi i kërkesave/ankesave të palëve dhe institucioneve.

10. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

Sektori i kadastrit i ka përfunduar të gjitha lëndët të cilat kanë mbetur në procedurë nga vitet paraprake, të cilat janë kompletuar pas përgjigjeve nga institucionet paraprake.

Gjatë muajit mars 2020, Sektori i kadastrit ka përfunduar gjithsej 130 lëndë të ndryshme të viteve paraprake, pasi që kemi pasur hapësirë të jashtëzakonshme t'i shqyrtojmë të gjitha me efikasitet dhe në afat të paraparë ligjor.

Gjatë muajit mars 2020, Sektori i gjeodezisë ka punuar 1529 lëndë.

Si rrjedhojë, nuk ka asnjë lëndë në procedurë.